

Urdhëresa mbi Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin- e vlefshme si fillim deri në 31 Tetor

Për cilët individë vlen detyrimi për të qëndruar në karantinë në shtëpi, kur hyjnë në vend?

Qeveria federale dhe Landet kanë rënë dakord që **udhëtarët të cilët hyjnë në vend nga zonat me rrezik duhet të qëndrojnë kryesisht 14 ditë në karantinë në shtëpi**. Në NRW kjo marrëveshje është implementuar tek Urdhëresa mbi Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin.

A duhet të njoftoj institucionin shëndetësor përkatës pas hyrjes në vend nga një zonë me rrezik?

Po, kushdo që hyn në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik duhet të kontaktojë institucionin shëndetësor përgjegjës dhe t'i informojë mbi qëndrimin e tyre tek zona me rrezik.

A ka përjashtime nga detyrimi i njoftimit?

Po, shikoni pyetjen "A ka përjashtime nga rregulli për karantinën".

Cilat shtete konsiderohen si zona me rrezik?

Klasifikimi si zonë me rrezik është kryer pas analizës së përbashkët dhe vendimit të marrë nga Ministria Federale e Shëndetësisë, Ministria e Jashtme Federale dhe Ministria Federale e Brendshme. Tek ky vlerësim janë marrë parasysh numri i infeksioneve të reja për 100.000 banorë si dhe rrethanat si për shembull lloji i shpërthimit të infeksionit (i kufizuar në nivel vendor apo kombëtar) dhe masat e marra për të kufizuar përhapjen e infeksionit. Një pasqyrë të zonave aktuale me rrezik mund ta gjeni [këtu](#).

A ka përjashtime nga rregulli për karantinën?

Detyrimi i karantinës nuk vlen nëse ekziston një testim negativ për koronavirusin i cili është zhvilluar maksimumi 48 orë para udhëtimit. Koha kur është përcaktuar rezultati i testimit është vendimtare për afatin e fundit. Testi mund të përsëritet në Gjermani; gjithsesi **duhet të ndiqen rregullat e karantinës derisa të merret rezultati i testit**. Për më tepër vlejné rregullat e mëtejshme:

- Mund të shpenzohen deri në 5 ditë për udhëtim në një zonë me rrezik ose për të hyrë në Nordrhein-Westfalen, në rast ardhje nga një zonë me rrezik, për arsye urgjente profesionale ose për arsye formimi profesional ose për zhvillimin e një trajtimi urgjent mjekësor.
- Mund të shpenzohen deri në 3 ditë për udhëtim në një zonë me rrezik për arsye të veçanta sociale ose familjare (për shembull kujdestari e përbashkët, vizitë nga partnerët e jetës, nga të afërmit të gradës së parë dhe të dytë etj.) ose për të hyrë në Nordrhein-Westfalen nëse vini nga një zonë me rrezik. Në të dyja rastet vlen gjithsesi detyrimi për të njoftuar tek institucioni shëndetësor përkatës vendor kur hyni nga një

zonë me rrezik. Nga data 7 tetor do të ketë një thjeshtëzim në kuptimin që personat të cilët udhëtojnë rregullisht në një zonë me rrezik për një nga arsyet e përmendura më përpara ose të cilët hyjnë në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik, e raportojnë këtë gjë vetëm 1 herë.

- Për më tepër, rregullorja e karantinës nuk vlen më për personat të cilët ndodhen në tranzit përmes Nordrhein-Westfalen (pa qëndruar tërë natën). Mund të shpenzohen deri në 24 orë për udhëtim në një zonë me rrezik ose për hyrjen në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik brenda hapësirës të së ashtuquajturës "Trafik i vogël kufitar". Për këto qëndrime të shkurtra, detyrimi për të njoftuar tek institucioni shëndetësor përkatës vendor do të hiqet duke filluar nga data 7 tetor.

Të gjitha përjashtimet vlejnë për sa kohë që nuk janë prezent simptoma të COVID-19.

Çfarë ndodh nëse unë nuk zbatoj rregullin për karantinën?

Kushdo që nuk zbaton rregullat e karantinës pra për shembull nëse braktis banesën ku po karantinohet ose mirëpret vizitorë, kryen një kundërvajtje administrative. Kjo mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 25.000 euro.

A mund të testohen për koronavirusin tek aeroportet në Nordrhein-Westfalen personat e kthyer nga zonat me rrezik?

Po, personat e kthyer nga zonat me rrezik mund të testohen për koronavirusin falas në 4 aeroporte në Nordrhein-Westfalen.

Kur do të bëhen të ditura rezultatet e testimit?

Udhëtarët mund të kontrollojnë normalisht brenda 3 ditëve për të parë rezultatet e testimit. Sipas Urdhëresës mbi Udhëtimet Hyrëse në Lidhje me Koronavirusin ata janë të detyruar të karantinohen në shtëpi, derisa të jetë i gatshëm një rezultat negativ.

A duhet të testohen udhëtarët e kthyer nga zonat me rrezik?

Kushdo që hyn në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik duhet të paraqesë një rezultat negativ testimi me kërkesë të institutit shëndetësor përgjegjës. Personat të cilët nuk e zbatojnë këtë gjë, janë të detyruar të tolerojnë një ekzaminim mjekësor për koronavirusin. Shkeljet mund të gjobiten.

Rregulloret e karantinës

Çfarë do të thotë „Karantinë“?

Karantina është një veçim i përkohshëm i personave të cilët dyshohen se janë të infektuar me koronavirus, ose i personave të cilët mund të mbartin dhe përhapin virusin. Nëse një person është i veçuar për shkak të një infeksioni të konfirmuar, kjo zakonisht nuk quhet karantinë, por izolim.

Cili është kuptimi i karantinës?

Karantina shërben për të na mbrojtur të gjithë ne nga infektimi me koronavirusin dhe për të kufizuar përhapjen e sëmundjes.

Kur duhet të karantinohem?

Kurdo që të jepet urdhër nga autoritetet. Një urdhër zyrtar shpallet kur ka rrezik të lartë që një person të jetë ekspozuar ndaj një infektimi. Një rrezik i lartë i tillë përcaktohet nëse një person ka patur kontakt në dy javët e fundit me një të sëmurë, diagnostikimi i të cilit me COVID-19 është konfirmuar nga një laborator.

Kontakt i ngushtë quhet nëse ke folur, je tështirë ose kollitur mbi të sëmurin për të paktën 15 minuta, ndërkohë që ai ose ajo ishte ngjites.

Pavarësisht të një rregulli zyrtar, kushdo që hyn në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik duhet të karantinohet. Karantina ka një kohëzgjatje prej 14 ditësh.

A ka përjashtime nga rregulli për karantinën?

Ajo çka urdhëron autoriteti përgjegjës është vendimtare.

Detyrimi i karantinës nuk vlen nëse ekziston një testim negativ për koronavirusin i cili është zhvilluar maksimumi 48 orë para udhëtimit. Koha kur është përcaktuar rezultati i testimit është vendimtare për afatin e fundit. Testi mund të përsëritet në Gjermani; gjithsesi **duhet të ndiqen rregullat e karantinës derisa të merret rezultati i testit**. Për më tepër vlejné rregullat e mëtejshme:

- Mund të shpenzohen deri në 5 ditë për udhëtim në një zonë me rrezik ose për të hyrë në Nordrhein-Westfalen, në rast ardhje nga një zonë me rrezik, për arsye urgjente profesionale ose për arsye formimi profesional ose për zhvillimin e një trajtimi urgjent mjekësor.
- Mund të shpenzohen deri në 3 ditë për udhëtim në një zonë me rrezik për arsye të veçanta sociale ose familjare (për shembull kujdestari e përbashkët, vizitë nga partnerët e jetës, nga të afërmit të gradës së parë dhe të dytë etj.) ose për të hyrë në Nordrhein-Westfalen nëse vini nga një zonë me rrezik. Në të dyja rastet vlen gjithsesi detyrimi për të njoftuar tek institucioni shëndetësor përkatës vendor kur hyni nga një zonë me rrezik. Nga data 7 tetor do të ketë një thjeshtëzim në kuptimin që personat të cilët udhëtojnë rregullisht në një zonë me rrezik për një nga arsyet e përmendura më përpara ose të cilët hyjnë në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik, e raportojnë këtë gjë vetëm 1 herë.
- Për më tepër, rregullorja e karantinës nuk vlen më për personat të cilët ndodhen në tranzit përmes Nordrhein-Westfalen (pa qëndruar tërë natën). Mund të shpenzohen deri në 24 orë për udhëtim në një zonë me rrezik ose për hyrjen në Nordrhein-Westfalen nga një zonë me rrezik brenda hapësirës të së ashtuquajturës "Trafik i vogël

kufitar". Për këto qëndrime të shkurtra, detyrimi për të njoftuar tek institucioni shëndetësor përkatës vendor do të hiqet duke filluar nga data 7 tetor.

Të gjitha përjashtimet vlejnë për sa kohë që nuk janë prezent simptoma të COVID-19.

Çfarë duhet të kem parasysh gjatë karantinës?

Karantinë do të thotë veçim nga të tjerët në ambient shtëpiak. Banesa ku po karantiniheni nuk duhet braktisur deri në fund të karantinës. Nuk mund të mikprisni vizitorë. Personat në karantinë i nënshtrohen mbikëqyrjes të institucionit shëndetësor përgjegjës.

Çfarë ndodh nëse unë nuk i ndjek rregullat e karantinës?

Individi i cili nuk ndjek rregullat e karantinës ndëshkohet me kundravajtje administrative. Kjo mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 25.000 euro.